



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar

Numër 10

M A R S 2 0 2 2

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve për Inflacionin

Numër 10

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar	4
Hyrje	4
Përmbledhja e rezultateve	4
Kutia 1. Metodologjia	7
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi	8
Kreditë ndaj ndërmarrjeve	8
Standardet kreditore	8
Kushtet dhe rregullat	9
Kërkesa për kredi	9
Kreditë ndaj ekonomive familjare	11
Standardet kreditore	11
Kushtet dhe rregullat	11
Kërkesa për kredi	12
Financimi	13
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara	14
Pritjet për Inflacionin	15
Metodologjia	16
Përmbledhja e rezultateve	16

Anketa e Kreditimit Bankar

Hyrje¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2021, dhe pritjet e bankave për dinamikat në kreditim për tremujorin e parë të vitit 2022.

Përveç pyetjeve standarde, kjo anketë është plotësuar me tre pyetje shtesë në përpjekje për të adresuar ndikimin e presioneve inflacioniste që ishin evidente veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit në dinamikat e kreditimit, si dhe ndikimin potencial në performancën e ripagimit të kredimarrësve. Gjithashtu, në pyetjet shtesë bëhet zbërthimi i ofertës dhe kërkesës kreditore sipas sektorëve ekonomik.

Përmbledhja e rezultateve²

Si rezultat i përmirësimit të situatës me pandeminë, e rrjedhimisht lehtësimit të masave kufizuese në vend dhe jashtë tij, aktiviteti ekonomik pati një rimëkëmbje të fuqishme në vitin 2021. Kreditimi dhe financimi i sektorit bankar shënuan rritje të konsiderueshme në gjysmën e dytë të vitit 2021, rritje që bashkë me rritjen e të hyrave formale dhe joformale të diasporës, mbështetën rikuperimin ekonomik në vend. Rritja vjetore e stokut të gjithsej kredive tejkaloi nivelin e rritjes vjetore të kreditimit parapandemik, dhe viti 2021 u mbyll me rritjen më të lartë vjetore të kreditimit në dhjetë vitet e fundit. Njëkohësisht, edhe kreditë e reja krahasuar me tremujorin paraprak dhe tremujorin e njëjtë të vitit paraprak shënuan rritje vjetore të theksuar, si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare. Këto dinamika të kreditimit u ndikuan në masë më të madhe nga kërkesa kreditore, e cila u rrit dyfish më shumë se sa që u lehtësua oferta kreditore. Për dallim nga tremujori aktual, bankat për TM1 2022 presin që aktiviteti kreditor i sektorit të mbështetet deri në një masë nga oferta kreditore, pasi që kërkesa për kredi pritjet të mos ketë ndryshime të rëndësishme.

Sipas bankave, dinamika e kreditimit të ndërmarrjeve gjatë këtij tremujori u ndikua në masë më të madhe nga kërkesa e rritur kreditore, përderisa oferta kreditore u lehtësua mirëpo në një nivel më të ulët. Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë lehtësuar deri në një masë standardet kreditore të aplikuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi në tremujorin e katërt të vitit 2021. Standardet kreditore u lehtësuan në nivel më të lartë për NVM-të se sa për ndërmarrjet e mëdha (tabela 1). Ndryshimet në standardet kreditore u ndikuan pozitivisht kryesisht nga mbështetja e kredive nga FKGK dhe presioni i rritur i konkurrencës në sektorin bankar. Njëkohësisht, bankat rritën edhe nivelin e aprovimit të kredive për ndërmarrjet, e veçanërisht për NVM-të.

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

² Pyetësori dhe seria kohore e rezultateve të AKB-së janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.

Për tremujorin e parë të vitit 2022, pritjet e bankave konsistojnë në lehtësim të standardeve kreditore në nivel të përafërt me atë në tremujorin aktual. Oferta kreditore bazuar në standardet kreditore deri në një masë pritjet të jetë më e favorshme për NVM-të se sa për ndërmarrjet e mëdha. Rritja e presionit të konkurrencës pritjet të ketë kontributin kryesor pozitiv në lehtësimin e standardeve kreditore gjatë TM1 2022.

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u lehtësuan deri në një masë. Kryesisht, kushte dhe rregulla të lehtësuara u aplikuan për të dy kategoritë e ndërmarrjeve përmes uljes së normës së interesit dhe uljes së kërkesës për kolateral. Faktorët që ndikuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave ishin mbështetja e NVM-ve nga FKGGK dhe rritja e presioneve të konkurrencës në sektorin bankar. Në tremujorin e parë të vitit 2022, bankat presin lehtësime të kushteve dhe rregullave për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, mirëpo në nivel më të ulët se sa në tremujorin e katërt të vitit 2021. Kushtet dhe rregullat e lehtësuara pritjet të jenë të ngjashme me ato të aplikuara gjatë tremujorit aktual. Lehtësimet në kushtet dhe rregullat e ndërmarrjeve pritjet të nxiten nga presionet e konkurrencës në tregun bankar, pozita e mirë e likuiditetit të sektorit bankar, si dhe mbështetja e NVM-ve nga FKGGK.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021, kishte rritje të theksuar të kërkesës për kredi bankare nga ndërmarrjet në krahasim me tremujorin paraprak. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet rezultoi të jetë nënvlerësuar në pritjet e bankave për TM4 2021, të shprehura në anketën e kaluar (TM3 2021), ku bankat prisnin rritje më të ulët të kërkesës për kredi. Kërkesa e rritur për kredi erdhi nga NVM-të, përderisa kërkesa për kredi nga ndërmarrjet e mëdha mbeti e pandryshuar. Kjo rritje e kërkesës, sipas deklaratave të bankave, u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues dhe për financimin investimeve fikse. Pritjet për aktivitet më të ulët ekonomik për shkak të sezonalitetit i kanë ndikuar edhe pritjet e bankave të cilat deklaruan se nuk presin ndryshime të rëndësishme të kërkesës për kredi gjatë tremujorit të ardhshëm nga të dy kategoritë e ndërmarrjeve, ku përgjigjet e bankave gjeneruan një indeks negativ margjinal (tabela 1). Faktori kyç që pritjet të ndikojë pozitivisht kërkesën për kredi nga ndërmarrjet është nevoja për financimin e investimeve fikse, edhe pse me intensitet të ulët bazuar në indeksin e gjeneruar.

Kreditë e reja për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të katërt 2021 kishin rritje të konsiderueshme në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ngjashëm me kreditimin e ndërmarrjeve, kërkesa kreditore ishte nxitësi kryesor i dinamikave të aktivitetit kreditues për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese, përderisa oferta kreditore kishte rol më të dobët në këtë aspekt. Standardet kreditore në tremujorin aktual, në përgjithësi, rezultojnë të jenë të përafërta me pritjet e bankave të shprehura në anketën e kaluar. Standardet kreditore u lehtësuan deri në një masë për kreditë konsumuese, përderisa për kreditë për blerjen e shtëpive nuk kishte ndryshime të rëndësishme. Këto lehtësime u ndikuan kryesisht nga presioni i rritur i konkurrencës në mes të bankave, si dhe nga perspektiva e përmirësuar e tregut vendor. Në tremujorin e parë 2022, bankat presin standarde kreditore të lehtësuara deri në një masë për kreditë për ekonomitë familjare. Standardet kreditore pritjet të lehtësohen në një nivel më të lartë për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive (tabela 1). Faktorët e njëjtë me ato të tremujorit aktual pritjet të jenë përcaktues të standardeve kreditore të aplikuara nga bankat për ekonomitë familjare edhe gjatë tremujorit të ardhshëm.

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare u lehtësuan deri në një masë. Niveli i lehtësimit të kushteve dhe rregullave ishte i përafërt si për kreditë për blerjen e shtëpive ashtu edhe për kreditë konsumuese. Të gjitha kushtet dhe rregullat e përfshira në anketë u lehtësuan, përveç pagesave tjera përveç interesit që mbetën të pandryshuara. Faktorët kyç që ndikuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021 ishin presioni i rritur i konkurrencës, perspektiva e mirë në tregun vendor në përgjithësi dhe atij bankar në veçanti, si dhe pozita e favorshme e likuiditetit të bankave. Për tremujorin e parë të vitit

2022, bankat deklaruan se presin që përgjithësisht kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare të lehtësohen, mirëpo në masë më të ulët se sa në tremujorin aktual. Lehtësim i kushteve dhe rregullave pritet për të dy llojet e kredive, mirëpo për kreditë për blerjen e shtëpive bankat pritet të ofrojnë kushte dhe rregulla më të volitshme. Kryesisht, kushtet dhe rregullat për kreditë për blerjen e shtëpive pritet të lehtësohen përmes zvogëlimit të normës së interesit dhe rritjes së shumës së aprovuar. Perspektiva e mirë e tregut në vend, si dhe rritja e presioneve të konkurrencës në tregun bankar pritet të jenë faktorët nxitës të lehtësimeve të kushteve dhe rregullave të aplikuara nga bankat gjatë TM1 2022.

Në linjë me rimëkëmbjen e fuqishme të aktivitetit ekonomik, kërkesa për kredi shënoi rritje të theksuar gjatë tremujorit të katërt krahasuar me tremujorin paraprak. Bankat raportuan për rritje më të lartë të kërkesës për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive. Saktësisht, nëntë nga gjithsej dhjetë banka pjesëmarrëse në anketë deklaruan rritje të kërkesës për kredi në përgjithësi. Kjo rritje u ndikua pozitivisht nga tre prej faktorëve të listuar në anketë, saktësisht nga nevoja për financim të konsumit, rritja e besueshmërisë së konsumatorëve, si dhe nga përmirësimi i perspektivës në tregun e patundshmërive. Në tremujorin e parë të vitit 2022, bankat nuk presin ndryshim të rëndësishëm të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare (tabela 1). Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat presin që përmirësimi i perspektivës në tregun e patundshmërive dhe rritja e besueshmërisë së konsumatorëve të ndikojnë kërkesën për kredi gjatë tremujorit të ardhshëm.

Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM4 2021	TM1 2022 (pritjet)	TM4 2021	TM1 2022 (pritjet)
Ndërmarrjet	↑	↔	↑	↓
NVM	↑	↔	↑	↓
Ndërmarrjet e mëdha	↔	↔	↔	↔
Ekonomitë familjare	↑	↑	↑	↔
Kredi për blerjen e shtëpive	↔	↔	↑	↔
Kredi konsumuese	↑	↑	↑	↔

↑	Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)
↔	Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)
↔	Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)
↓	Shtyrje në standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)
↓	Shtyrje në standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)

Burimi: BQK.

Qasja mbështetëse e bankave kundrejt nevojave të klientëve të vet, monitorimi vigjilent i performancës së klientëve, si dhe rimëkëmbja ekonomike si pasojë e zhvillimeve pozitive globale dhe rritjes së të hyrave nga jashtë në vend ndihmuan në përmirësimin e performancës së ri-pagimit të kredive. Rrjedhimisht, bankat deklaruan përmirësim të portfolios kreditore, pasi që indeksi i përgjigjeve në këtë tremujor kaloi në negativ nga indeksi pozitiv në tremujorin e kaluar, e që nënkupton rënie të raportit në mes kredive jo-performuese dhe gjithsej kredive. Përmirësim të cilësisë së portfolios kreditore kishte si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare. Në tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi, bankat nuk presin ndryshim të rëndësishëm në vlerën e kredive jo performuese.

Përkundër rritjes së theksuar në tremujorin e kaluar (TM3 2021), gjatë tremujorit të katërt financimi i sektorit bankar u rrit konsiderueshëm. Rritje të financimit deklaruan të gjitha bankat e përfshira në anketë. Ngjashëm me tremujorin e kaluar, financimi i bankave u dominua nga rritja e

konsiderueshme e depozitave afatshkurtra të ekonomive familjare. Saktësisht, shtatë banka deklaruan rritje të depozitave nga ekonomitë financiare, ku prej tyre dy banka me rëndësi sistematike deklaruan rritje të konsiderueshme. Bankat i'a atribuon rritjen e depozitave hezitimit për investim nga subjektet ekonomike gjatë periudhës së pandemisë, dërgesave të larta të remitencave, si dhe vizitave në numër të lartë të diasporës në vend. Financimi nga depozitat e ndërmarrjeve, nga bankat amë dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare shënoi poashtu rritje, mirëpo në nivel më të ulët. Gjatë tremujorit të ardhshëm, bankat presin që rritja e financimit të vazhdojë përmes rritjes së depozitave afatshkurtra nga ekonomitë familjare, edhe pse në nivel më të ulët se sa gjatë tremujorit aktual. Gjithashtu, pritet që financimi nga bankat amë dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare të vazhdojë të kontribuojë pozitivisht në financimin e sektorit.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar

Pyetësi i AKB është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKB është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKB përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritjet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKB mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga njëmbëdhjetë bankat që operojnë në Kosovë³. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithësej sektorit bankar dhe 99.8 përqind të gjithësej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka

³ Banka e cila nuk është përfshirë në anketë është Komercialna Banka e cila ka aktivitet kreditor të limituar.

në gjithësej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë.

Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.


Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi

Kreditë ndaj ndërmarrjeve

Standardet kreditore

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021, standardet kreditore (udhëzimet e brendshme të bankave apo kriteret për aprovimin e kredive) të aplikuara për ndërmarrjet në përgjithësi paraqesin lehtësim, i cili ishte më i lartë në krahasim me tremujorin paraprak me indeks pozitiv prej 0.22 nga 0.15 në anketën paraprake. Në anketën e kaluar (TM3 2021), bankat kishin deklaruar se presin standarde kreditore të lehtësuara në një nivel të përafërt me atë aktual (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, bankat deklaruan indeks pozitiv 0.22 për ndryshimet në standardet kreditore për NVM-të, dhe ndryshime marginale me indeks pozitiv të ulët 0.09 për ndërmarrjet e mëdha. Saktësisht, ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e katër bankave pjesëmarrëse të cilat deklaruan lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore për NVM-të, përderisa dy nga bankat deklaruan lehtësim të standardeve për ndërmarrjet e mëdha kundrejt dy bankave tjera që deklaruan shtrëngim për të njëjtat.

Rol kryesor në lehtësimin e standardeve kreditore të aplikuara nga bankat në TM4 2021 rezulton të kenë luajtur mbështetja e ndërmarrjeve në kreditim nga FKGK me një indeks pozitiv prej 0.48 (përgjigje nga pesë banka, tre nga bankat i atribuan kontribut të konsiderueshëm), dhe rritja e presioneve të konkurrencës në tregun bankar me indeks pozitiv prej 0.39 (faktorë i deklaruar nga katër banka, prej tyre dy i atribuan kontribut të konsiderueshëm). Norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet gjatë këtij tremujori u rrit dukshëm në krahasim me tremujorin paraprak. Norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet u rrit për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, edhe pse kjo normë ishte dyfish më e lartë për NVM-të se sa për ndërmarrjet e mëdha. Saktësisht, ky rezultat u ndikua

nga përgjigjet e gjashtë bankave pjesëmarrëse të cilat deklaruan rritje të normës së aprovimit të kredive për NVM-të, përdërisa katër nga bankat deklaruan të njëjtën për ndërmarrjet e mëdha.


Bankat pritët t'i lehtësojnë standardet kreditore deri në një masë gjatë TM1 2022. Tre nga dhjetë bankat pjesëmarrëse në anketë, prej tyre një me rëndësi sistematike, presin që rritja e presionit të konkurrencës të ketë kontributin kryesor në lehtësim të standardeve kreditore për ndërmarrjet. Gjithashtu, kontribut pozitiv pritët të ketë pozita e favorshme e likuiditetit në sektorin bankar. Konkretisht, lehtësimi i standardeve kreditore pritët të jetë në një nivel më të ulët se sa ndryshimi në tremujorin aktual, ku pas indeksimit të përgjigjeve rezultoi një indeks pozitiv për NVM-të prej 0.18, dhe indeks pozitiv prej 0.09 për ndërmarrjet e mëdha.

Në anën tjetër, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet nuk pritët të ketë ndryshim të rëndësishëm gjatë tremujorit të ardhshëm.

Kushtet dhe rregullat

Në TM4 2021, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet dhe rregullat përkatëse të një kontrate të caktuar për kredi) u lehtësuan mirëpo në një nivel të ulët (grafiku 2). Sektori bankar aplikoi lehtësim të njëjtë të kushteve dhe rregullave për kreditë e reja si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Konkretisht, për të dy kategoritë e ndërmarrjeve lehtësim deri në një masë kishte në normën e interesit të aplikuar (indeks pozitiv prej 0.23 për NVM-të dhe 0.19 për ndërmarrjet e mëdha) dhe në kërkesën për kolateral për kreditë e aprovuara (me indeks pozitiv prej 0.23 dhe 0.12 për ndërmarrjet e mëdha).

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Faktori me kontributin kryesor dhe indeks të lartë pozitiv në lehtësimin e kushteve dhe rregullave vazhdon të jetë mbështetja e NVM-ve nga FKGK me indeks pozitiv prej 0.48. Gjithashtu, pozitivisht kontribuoi edhe rritja e presioneve të konkurrencës nga sektori bankar me indeks pozitiv të lartë prej 0.40.

Bankat gjatë TM1 2022 pritët të aplikojnë kushte dhe rregulla të lehtësuara mirëpo në nivel të ulët. Në këtë kontekst, ngjashëm me tremujorin aktual, bankat deklaruan që presin lehtësim të ngjashëm të kushteve dhe rregullave për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, përmes ofrimit të çmimit më të volitshëm për kredi (indeks pozitiv 0.10 për të dy kategoritë e ndërmarrjeve), si dhe kërkesave më të ulëta për kolateral (indeks pozitiv 0.16 për NVM-të dhe 0.10 për ndërmarrjet e mëdha). Lehtësimet në kushtet dhe rregullat e ndërmarrjeve pritët të nxiten nga presionet e konkurrencës në tregun bankar, pozita e mirë e likuiditetit të sektorit bankar, si dhe mbështetja e NVM-ve nga FKGK.


Kërkesa për kredi

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021, kërkesa për kredi nga ana e ndërmarrjeve shënoi rritje të konsiderueshme krahasuar me TM3 2021. Kërkesa për kredi rezultoi të jetë nënvlerësuar në pritjet e bankave për TM4 2021 të shprehura në anketën e kaluar (TM3 2021) (grafiku 3). Konkretisht, kërkesa për kredi nga NVM-të kishte rritje të konsiderueshme me indeks pozitiv prej 0.48, përderisa kërkesa kreditore nga ndërmarrjet e mëdha mbeti e pandryshuar. Indeksi i gjeneruar për kërkesën për kredi u ndikua nga përgjigjet e tetë bankave të cilat deklaruan rritje të kërkesës, ku tre prej tyre deklaruan rritje të konsiderueshme.

Sipas anketës, ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet u ndikuan kryesisht nga kërkesa për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, si dhe financimin e investimeve fikse me indeks pozitiv të lartë prej 0.46 dhe 0.38, respektivisht. Rezultati i faktorëve kontribuues në kërkesën për kredi u përcaktua nga përgjigjet e nëntë bankave të cilat deklaruan ndikim pozitiv të kërkesës për financim të inventarëve dhe kapitalit punues dhe shtatë bankave për financim të investimeve fikse. Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet u përmirësua deri në një masë gjatë TM4 2021, saktësisht me indeks pozitiv prej 0.19 për aplikacionet e NVM-ve dhe 0.11 për aplikacionet e ndërmarrjeve të mëdha.

Sipas anketës, gjatë TM4 2021 raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve ndaj gjithsej kredive gjeneroi indeks negativ prej 0.31, për dallim nga anketa e kaluar ku bankat deklaruan indeks pozitiv të këtij raporti, e që nënkupton përmirësim të cilësisë së portfolios kreditore. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e gjashtë bankave të cilat deklaruan rënie të kredive joperformuese.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Bankat nuk presin ndryshime të rëndësishme të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet gjatë tremujorit të ardhshëm. Sidoqoftë, dy banka me rëndësi sistemike dhe peshë të madhe në kreditimin e sektorit bankar, deklaruan që presin rënie deri në një masë të kërkesës për kredi, përderisa tre banka tjera, prej tyre njëra më rëndësi sistemike, deklaruan që presin rritje të kërkesës për kredi. Rrjedhimisht, këto përgjigje rezultuan në një indeks negativ marginal prej 0.06. Nevoja për financimin e investimeve fikse pritet të jetë nxitësi i vetëm i kërkesës për kredi me indeks pozitiv të ulët prej 0.13. Njëkohësisht, bankat nuk presin ndryshim të rëndësishëm të cilësisë së aplikacioneve për kredi nga ndërmarrjet.

Njëkohësisht, gjatë tremujorit të ardhshëm bankat nuk presin ndryshim të rëndësishëm në raportin e kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet.


Kreditë ndaj ekonomive familjare

Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021 përgjithësisht u lehtësuan, megjithëse lehtësimi kryesisht ndikoi në standardet kreditore për kreditë konsumuese ndërkohë që standardet kreditore për kreditë për blerjen e shtëpive mbeten kryesisht të pandryshuara. Rezultati kryesisht reflekton përgjigjet e katër bankave, ku tre prej tyre janë me rëndësi sistematike. Pritjet për tremujorin e katërt 2021 të deklaruara nga bankat në anketën e kaluar rezultuan të sakta (grafiku 4). Bankat deklaruan të kenë rritur dukshëm normën e aprovimit të kredive për ekonomitë familjare, dhe atë në një masë më të madhe për kreditë për blerjen e shtëpive, me indeks pozitiv prej 0.33, se sa për kreditë konsumuese me indeks pozitiv prej 0.27. Shkalla më e lartë e aprovimit për kreditë për blerjen e shtëpive kundrejt kredive konsumuese, ndër tjerash, mund të jetë ndikuar nga kampanjat/marrëveshjet ekzistuese me kompanitë ndërtuese të cilat ndikojnë në lehtësimin e kriterëve për aprovim, si dhe, nga cilësia e aplikacioneve të pranuar për këtë segment kundrejt kredive konsumuese.

Faktorë që kontribuan pozitivisht në lehtësimin e standardeve kreditore ishin rritja e presioneve të konkurrencës me indeks pozitiv prej 0.39, perspektiva e mirë e tregut të brendshëm në përgjithësi dhe atij bankar në veçanti me indeks pozitiv prej 0.30 dhe 0.18, respektivisht.

Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan




Në tremujorin e parë 2022, bankat presin standarde kreditore të lehtësuara deri në një masë për kreditë për ekonomitë familjare. Standardet kreditore pritet të lehtësohen në një nivel më të lartë për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive, me indeks pozitiv prej 0.23 dhe 0.12, respektivisht. Standardet kreditore pritet të ndikohen pozitivisht nga rritja e presioneve të konkurrencës dhe perspektiva e mirë e tregut bankar në vend. Njëkohësisht, bankat presin rritje të nivelit të aprovimit të kredive, mirëpo në një nivel më të ulët se sa vlerat aktuale në TM4 2021. Saktësisht, rezultatet e përgjigjeve gjeneruan indeks pozitiv prej 0.18 për kreditë konsumuese dhe 0.10 për kreditë për blerjen e shtëpive.

Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u lehtësuan në tremujorin e katërt të vitit 2021. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave ishte i përafërt si për kreditë për blerjen e shtëpive ashtu edhe për kreditë konsumuese, bazuar në nivelin e indeksit të gjeneruar. Pothuajse të gjitha kushtet dhe rregullat të përfshira në anketë u lehtësuan, përveç pagesave tjera përveç interesit që mbetën të pandryshuara. Saktësisht, për kreditë për blerjen e shtëpive, bankat aplikuan normë më të ulët të interesit (indeks pozitiv prej 0.23), ulën kërkesat për kolateral (indeks

pozitiv prej 0.19), rritën shumën e kredive të aprovuara si dhe zgjatën maturitetin e kredive (indeks pozitiv i ulët prej 0.10). Ndërsa për kreditë konsumuese bankat aplikuan lehtësime në nivel më të ulët, kryesisht në kërkesat për kolateral (indeks pozitiv prej 0.19), si dhe në normën e interesit, shumën dhe maturitetin (indeks pozitiv prej 0.16) (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

* Vlera e pritur

Faktorët kryesor që kontribuuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara janë kryesisht presioni i rritur i konkurrencës, perspektiva e mirë e tregut vendor në përgjithësi dhe atij bankar në veçanti, si dhe pozita e kënaqshme e likuiditetit të sektorit. Gjithashtu, në këto lehtësime ndikoi edhe lehtësimi i masave kufizuese për parandalimin e shpërndarjes së virusit Covid-19.

Për tremujorin e parë të vitit 2021, bankat presin që kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare të lehtësohen në një nivel më të ulët se sa gjatë tremujorit aktual. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë deri në një masë më të lartë për kreditë për blerjen e shtëpive. Kryesisht, kushtet dhe rregullat për kreditë për blerjen e shtëpive pritet të lehtësohen përmes zvogëlimit të normës së interesit dhe rritjes së shumës së aprovuar me indeks pozitiv prej 0.13. Ndërsa, për kreditë konsumuese pritet të ketë lehtësim në normën e interesit me indeks pozitiv të ulët prej 0.10. Perspektiva e mirë e tregut në vend, si dhe rritja e presioneve të konkurrencës në tregun bankar pritet të jenë faktorët nxitës të lehtësimeve të kushteve dhe rregullave të aplikuara nga bankat gjatë TM1 2022.


Kërkesa për kredi

Bankat në këtë tremujor raportuan për rritje të konsiderueshme të kërkesës nga ekonomitë familjare në krahasim me rritjen e ulët të kërkesës gjatë tremujorit të kaluar (TM3 2021). Nëntë nga gjithsej dhjetë banka pjesëmarrëse në anketë deklaruan rritje të kërkesës për kredi në përgjithësi, e që pas indeksimit të përgjigjeve rezultoi me indeks pozitiv të lartë prej 0.55. Bankat raportuan për rritje më të lartë të kërkesës për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.47 dhe 0.33, respektivisht. Nëse krahasojmë rezultatet aktuale të kërkesës për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për të njëjtën periudhë, niveli aktual i rritjes së kërkesës është më i lartë, ndikuar nga vlera aktuale e kërkesës për të dy kategoritë të cilat janë më të larta se sa pritjet e deklaruara nga bankat (grafiku 6).

Kjo rritje u ndikua pozitivisht kryesisht nga tre prej faktorëve të listuar në anketë, saktësisht nga nevoja për financim të konsumit, rritja e besueshmërisë së konsumatorëve, si dhe nga përmirësimi i perspektivës në tregun e patundshmërive me indeks pozitiv prej 0.37, 0.28 dhe 0.21, respektivisht. Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare për kredi gjatë këtij tremujori u përmirësua për të dy llojet e kredive në nivel të ngjashëm, saktësisht me indeks pozitiv prej 0.23 aplikacionet për kreditë për blerjen e shtëpive dhe indeks pozitiv prej 0.22 për aplikacionet për kreditë konsumuese.

Sa i përket cilësisë së portfolios kreditore për ekonomitë familjare, bankat deklaruan përmirësim, duke reflektuar përgjigjet e tre bankave me rëndësi sistemike për rënie të raportit të kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare, e që rezultuan në një indeks negativ 0.21.

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Burimi: BQK.

* Vlera e pritur

Në tremujorin e parë të vitit 2021, bankat nuk presin ndryshime të rëndësishme në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare. Sidoqoftë, ky rezultat u ndikua nga pritjet e dy bankave me rëndësi sistemike dhe peshë të madhe në kreditimin e sektorit, të cilat presin rënie të kërkesës kreditore, gjë që neutralizoi rritjen e kërkesës për kredi të deklaruar nga katër banka tjera. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat ia atribuuan këto pritje perspektivës në tregun e patundshmërive dhe besueshmërisë së konsumatorëve.

Për dallim nga tremujori aktual (TM4 2021), bankat presin që cilësia e portfolios kreditore e ekonomive familjare të mbetet e pandryshuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2022. Njëkohësisht, bankat deklaruan se presin përmirësim në një nivel të ulët të cilësisë së aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare, kryesisht për kreditë konsumuese me një indeks pozitiv prej 0.11.

Financimi


Bankat raportuan rritje të konsiderueshme të qasjes në financim gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021. Duke marrë parasysh modelin tradicional të sektorit bankar në Kosovë, financimi vazhdoi të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare. Të gjitha bankat pjesëmarrëse në anketë deklaruan rritje të financimit gjatë këtij tremujori, një prej tyre (bankë me peshë të madhe dhe me rëndësi sistemike në sektor) deklaroi rritje të konsiderueshme të financimit.

Financimi kishte rritje të konsiderueshme edhe gjatë tremujorit të kaluar, megjithatë, rritja e shënuar këtë tremujor rezulton të ketë qenë shumë më e lartë. Gjithsej financimi gjeneroi indeks të lartë pozitiv prej 0.61, ku dominuan depozitat afatshkurtra të ekonomive familjare me një indeks pozitiv prej 0.49. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e shtatë nga gjithsej dhjetë banka pjesëmarrëse në anketë. Për dallim nga tremujori i kaluar, financimi nga depozitat e ndërmarrjeve u rrit në nivel dukshëm më të lartë prej 0.24 (indeks negativ prej 0.10 në TM3 2021), duke reflektuar gjithashtu përgjigjet e shtatë bankave pjesëmarrëse. Njëkohësisht, financimi nga institucionet ndërkombëtare financiare dhe bankat amë kontribuan pozitivisht në financimin e sektorit bankar mirëpo me një indeks të ulët prej 0.12 dhe 0.14, respektivisht (grafiku 7). Sipas maturitetit, depozitat afatshkurtra ishin burimi kryesor për financim gjatë këtij tremujori me një indeks pozitiv prej 0.45.

Për tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje të qasjes në financim, mirëpo me një ritëm dukshëm më të ngadalshëm se sa ai i tremujorit aktual. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar me indeks pozitiv prej 0.28, përderisa financimi nga depozitat e ndërmarrjeve pritet të ketë lëvizje marginale me indeks pozitiv

prej 0.09. Gjithashtu, bankat deklaruan se presin që rritjen e financimit ta dominojnë depozitat me maturitet afatshkurtër me indeks pozitiv 0.28 (grafiku 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Rezultatet e pyetjeve të fokusuara

Pyetësori i anketës për tremujorin e katërt të vitit 2021 është plotësuar me tre pyetje shtesë, në përpjekje për të adresuar ndikimin e presioneve inflacioniste që ishin evidente veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit në dinamikën e kreditimit. Gjithashtu, një nga pyetjet zbërthejnë ofertën dhe kërkesën kreditore sipas sektorëve ekonomik.

Me lehtësimin e masave kufizuese në vend dhe jashtë tij gjatë vitit 2021, aktiviteti ekonomik kishte një rimëkëmbje të fuqishme në vitin 2021, e reflektuar në rritje të lartë të BPV në baza tremujore, veçanërisht në tremujorin e dytë. Kjo rritje u mbështet nga rritja e kërkesës së brendshme, masat lehtësuese të Qeverisë, masave të BQK-së përmes moratoriumit dhe ristrukturimit të kredive, si dhe financimit të lartë nga të hyrave nga diaspora. Sidoqoftë, si në vend ashtu edhe në nivel global, ky rikuperim dhe faktor tjerë që ndërliidhen me pandeminë u përkthyen në rritje të përgjithshme të çmimeve. Duke qenë se rritja e çmimeve ndikon negativisht fuqinë blerëse të konsumatorëve, është me rëndësi të kuptohet sjellja e sektorit bankar në të bërit biznes në këto dinamika, dhe perceptimi i sektorit për aftësinë paguese të klientëve.

Bankat deklaruan që gjatë tremujorit të katërt nuk ka pas ndryshim të ofertës kreditore dhe se nuk është vërejtur ndryshim i rëndësishëm në kërkesën për kredi si pasojë e rritjes së çmimeve në vend. Sidoqoftë, pothuajse të gjitha bankat theksuan se efekti i rritjes së çmimeve ka më shumë gjasa të reflektohet në sjelljen e sektorit bankar gjatë TM1 2022 dhe TM2 2022. Ndryshimin më të madh bankat e presin të kërkesa për kredi, veçanërisht nga ekonomitë familjare. Sipas bankave, ekonomitë familjare pritet të rrisin kërkesën për kredi, më saktësisht për kredi konsumuese me maturitet afatshkurtër si rezultat i rënies së fuqisë blerëse. Në anën tjetër, një nga bankat theksoi se pret që investimet e planifikuara, klientët mund t'i shtyjnë deri në një periudhë të stabilizimit të çmimeve në treg.

Aspekt tjetër i mbuluar nga pyetjet shtesë ishte edhe ndikimi i rritjes së çmimeve në aftësinë e ripagimit të kredive nga klientët. Sentimenti i bankave nga përgjigjet e marra tregon se bankat besojnë në kapacitetin absorbues të klientëve të tyre, në periudhën afatshkurtër. Bankat i mbështetën këto pritje në procesin e tyre të shqyrtimit të aplikacioneve për kredi dhe kujdesit që klientët mos të mbingarkohen me borxh kundrejt të hyrave përkatëse që kanë. Sidoqoftë, disa nga bankat deklaruan se presin që gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, duke marr parasysh vazhdimin e presioneve inflacioniste në vend dhe jashtë tij, të ndikohet negativisht aftësia ripaguese e klientëve, e rrjedhimisht edhe cilësia e portfolios kreditore të bankave.

Përgjigjet e disagreguara të bankave për ndërmarrjet, sipas sektorëve, tregojnë për kahjen e financimit të ekonomisë dhe dinamikat në sektorë të caktuar. Gjatë tremujorit të katërt, bazuar në lehtësimet e standardeve kreditore, sektori i prodhimit përbën sektorin me ofertën më të volitshme. Përgjigjet e katër bankave, e prej tyre dy banka me rëndësi sistematike dhe me peshë të lartë në gjithësej kreditimin e sektorit, reflektojnë lehtësime të standardeve kreditore për këtë sektor, ku njëra prej tyre deklaroi lehtësime të konsiderueshme që rezultoi në indeks pozitiv prej 0.29. Tjetër, për kreditë ndaj sektorit të shërbimeve dhe atij të tregtisë u aplikuan poashtu standarde kreditore të lehtësuara, saktësisht me indeks pozitiv 0.20 dhe 0.16, respektivisht. Njëkohësisht, edhe kushtet dhe rregullat u lehtësuan në masë më të lartë për kreditimin e sektorit të prodhimit me indeks pozitiv 0.35. Sektorë tjerë me kushte dhe rregulla të lehtësuara ishin sektori i tregtisë dhe sektori i shërbimeve, që rezultuan me indeks pozitiv 0.29 dhe 0.25, respektivisht. Kërkesa për kredi shënoi rritje për të gjithë sektorët. Sektorët me kërkesën më të lartë për financim ishin ai i prodhimit dhe i tregtisë me indeks pozitiv prej 0.39. Gjithashtu, sektori i patundshmërive banesore dhe ai i shërbimeve kishin kërkesë të rritur gjatë TM4 2021, të përkthyer në indeks pozitiv prej 0.29 dhe 0.26, respektivisht.

Për TM1 2022, bankat presin që standardet kreditore të lehtësohen kryesisht për sektorin e prodhimit dhe atë të tregtisë. Ngjashëm, edhe kushtet dhe rregullat pritet të lehtësohen në masë më të madhe për sektorin e prodhimit, tregtisë dhe atij të shërbimeve në një masë më të ulët. Në të njëjtën periudhë, kërkesa për kredi nuk pritet të ketë ndryshime të rëndësishme, ku sipas pritjeve të bankave pjesa më e madhe e sektorëve u përkthyen në indekse marginale. Kërkesa për financimin e sektorit të patundshmërive pritet të bie, sidoqoftë kjo pritje nga përgjigjet e bankave u karakterizua me indeks negativ marginal prej 0.10.

Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK ankton institucionet financiare në vend, duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikat e inflacionit. Si rezultat, nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKB është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet në çmime në vend, duke ndihmuar kështu dhe plotësuar analizat tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit, përveç deklarimit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin paraprak, pyetësi adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e parë të vitit 2022 dhe për vitin 2022 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet të cilat e kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit. Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore të shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht vlerësimet për tremujorin paraprak si dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm dhe vitin aktual në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.

Përmbledhja e rezultateve

Bazuar në anketën e realizuar në janar të vitit 2022, bankat kanë vlerësuar nivel më të lartë të inflacionit në tremujorin e katërt të vitit 2021 krahasuar me tremujorin paraprak dhe presin një nivel të ngjashëm në tremujorin e parë të vitit 2022. Dinamikat që kanë karakterizuar lëvizjen e çmimeve gjatë periudhës raportuese u reflektuan në pritjet inflacioniste të bankave komerciale: 5.1 përqind në TM1 2022 nga 5.0 përqind sa e kanë vlerësuar për tremujorin paraprak (tabela 2). Për vitin 2022, bankat presin se niveli i inflacionit do të jetë 3.8 përqind nga 3.4 përqind sa ishte në vitin 2021. Anketa e realizuar përfshinë edhe efektet potenciale që presin bankat pas përballjes me pandeminë Covid-19.

Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për tremujorin e katërt të vitit 2021 sugjerojnë se norma mesatare vjetore e inflacionit ishte rreth 6.4 përqind, gjë që dëshmon për një nënvlerësim të shkallës së inflacionit nga bankat. Për tremujorin e parë të vitit 2022, bankat presin që norma mesatare e inflacionit do të jetë 5.1 përqind. Shumica e bankave (6 sosh) presin që inflacioni do të jetë mbi 4 përqind, ndërsa bankat tjera (4 sosh) presin se inflacioni do të jetë në intervalin nga 3 deri në 4 përqind.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM4 2021	TM1 2022	2022
1	3.5%	3.7%	3.5%
2	6.7%	6.5%	4.9%
3	3.4%	3.0%	2.7%
4	6.4%	8.6%	6.8%
5	6.7%	6.5%	3.5%
6	6.4%	5.5%	3.7%
7	3.4%	3.8%	3.5%
8	4.0%	4.0%	4.0%
9	6.7%	6.1%	2.5%
10	2.8%	3.1%	3.1%
Mesatarja	5.0%	5.1%	3.8%

Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.


Siç ilustron figura 8, shpërndarjet e raportuara të probabilitetit tregojnë për një siguri relativisht të lartë në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit, pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur.

Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë cituar arsyet e mundshme për rritjen e shkallës së inflacionit:

- ✓ Faktorë të përkohshëm të brendshëm dhe të jashtëm që i atribuohen rritjes së aktivitetit ekonomik, si rezultat i zbutjes së masave pandemike, rënies së numrit të të infektuarve me virus si dhe vaksinimit të popullsisë. Pra, situata më optimiste sa i përket pandemisë ka ndikuar në rritje të aktivitetit ekonomik dhe rrjedhimisht të nivelit të inflacionit;
- ✓ Kufizimet në ofertë si rezultat i pengesave të krijuara në zinxhirët e furnizimit si pasojë e pandemisë Covid-19, ku shumë kompani po e kanë të vështirë të gjejnë lëndë të para për të prodhuar produktet e tyre. Për më tepër, rritja e kostos së transportit detar ka ndikuar në rritjen e çmimeve, sidomos të vajit, derivateve, materialit ndërtimorë, etj.;
- ✓ Rritja e çmimeve të derivateve të naftës por edhe të kategorive të tjera janë reflektuar në rritjen e përgjithshme të çmimeve. Për më tepër, rritja e çmimeve të energjisë pritet të ndikojnë akoma më tej në rritjen e çmimeve. Pra, zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si dhe prodhimi i ulët në Kosovë dhe varësia e madhe e ekonomisë së vendit nga importet ka ndikuar në rritjen e çmimeve.

Pritjet e bankave për TM1 2022 janë në përputhje me trendin më të lartë të inflacionit ndërsa për gjithsej vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, duke pasur parasysh dinamikat me të cilat po karakterizohen çmimet në vend, mendojmë se pritjet e bankave janë të ulëta.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM1 2022 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org